



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës

Nr.04 61-284942016

Kaçanik, 19.08.2016

Në bazë të Ligjit nr. 04/L- 032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës shpallë:

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË GJIMNAZ DHE SHKOLLËN PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2016/2017

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt
Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2016/17, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.
2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim
Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:
Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron),
Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
Certifikatën e lindjes.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2016/2017, bëhet më datën 22, 23 dhe 24 Gusht 2016 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00. Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 25.08.2016. Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes

ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (25%) 25 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (15%) 15 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (60%) 60 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

SHMP"FERIZ GURI DHE VËLLEZËRIT ÇAKA"- KAÇANIK

Numri i nxënësve të pranuar në afatin e Qershorit dhe vendet e lira për afatin e Gushtit në SHMP"Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" për vitin shkollor 2016/17

Nr.	DREJTIMI	PROFILI	Nr. i paraleleve	Nr.i nxënësve që duhet të pranohen	Nr.i nxënësve të pranuar në afatin e Qershorit	Vendet e lira afati i Gushtit
1.	ELEKTROTEKNIKË	- Teknik i telekomunikacionit - Teknik i informatikës - Instalues elektrik	1 1 1	32 32 24	4 5 17	28 27 7
2.	EKONOMI	- Banka dhe sigurime - Asistent i marketingut - Tregtar me pakicë dhe shumicë	1 1 1	32 32 32	3 11 -	29 21 32
3.	MAKINERI	- Transport rrugor - Instalues i ngrohjes qendrore - Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit - Salldator - Automekanik	1 1 1 1 1	32 24 24 24 24	15 16 17 6 8	17 8 7 18 16
4.	JURIDIK	- Asistent juridik	1	32	15	17
5.	BJQËSI	Pemtari-vreshtari	1	32	-	32
Gjithsej			13	376	117	259

Gjinnazi 'Skënderbeu' - Kaçanik

Nr.	DREJTIMI	Nr. i paraleleve	Nr.i nxënësve
1.	Shkenca Natyrore	1	34

Drejtori i Drejtorisë

Z. Enver Kamishi

